REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 133/17
Datë/Datum. 08.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: ***Korporata Energjetike e Kosovës***

Për Aktivitetin e Prokurimit: **KEKO 16 399 111**

Sa i përket tenderit për: "**Furnizimi me platformë transportuese**"

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NTSH EKOINVEST
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Agim Ramadani 511/9
(Adresa)

Prishtine — *10000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

+377 44 30 30 68 — _____
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Lorik Kocani
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@ekoinvest.co
(Adresa elektronike)

08.05.2017 — _____
(Data e parashtrimit të kërkesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

Ndërmarrja Tregtare Shërbyese EKO INVEST PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Data e publikimit: 08.12.2016 *Data e dorëzimit te tenderëve: 03.02.2017* *Njoftimi për dhënie te kontratës: 20.04.2017* *Njoftimi për tenderuesin e pasuksesshëm: 20.04.2017* *Data e parashtrimit te kërkesës per rishqyrtim: 25.04.2017* *Data e vendimit nga AK KEK: 28.04.2017*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

Nuk ka verejtje

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] Jo [ ]

Ne me date 25.04.2017 kemi parashtruar kerkese per rishqyrtim pranë AK KEK.
Me date 28.04.2017 kemi pranuar vendimin nga AK, te cilët e kane hedhur poshtë si te pabazuar kërkesën tone për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 18 – Dosja e tenderit - i Rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurim publik
Neni 39 - Sqarimi i tenderit - i Rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurim publik
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 7 Barazia ne trajtim Jo-diskriminimi
Neni 10 Mjetet per promovimin e transparencës,
Neni 11 Informatat sekrete Afariste

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datë 20.04.2017, jemi njoftuar për tenderuesin e pasuksesshëm për projektin në "Furnizim me platforme transportuese". Në të njëjtën ditë kemi kërkuar qasje në dokumentacionin tenderik, e cila na është mundësuar me date: 21.04.2017.

Gjatë qasjes në dokumentacionin tenderik nuk na është lejuar qasja e pakufizuar ashtu siq e parashohin dispozitat ligjore, përkatësisht neni 10 i Lpp-se – Mjetet për promovimin e transparaences.
Neve na është lejuar qasja vetëm ne formularin e tenderit e cila është e përberë nga Pjesa C dhe lista e çmimeve.
Për këtë çështje dhe disa te tjera ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK KEK, mirëpo kërkesa jone refuzuar si e pabazuar.

Ne ato pak dokumente ne te cilat na është ofruar qasje, kemi vërejtur shkelje flagrante te neneve 59 te Lpp-se, 18 te Rregullave dhe UOPP-se si dhe nenit 39 te Rregullave dhe UOPP-se, për faktin se komisioni i vlerësimit të AK nuk i ka respektuar dispozitat në fjalë me rastin e vlerësimit te këtij tenderit.

OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar Pjesa C:Formulari për dorëzimin e ofertës konform dispozitave ligjore dhe kërkesave te AK.

Ne piken 7 te PJESA 1 Formulari i tenderit, aty ku kërkohet vendosja e numrit te lotëve OE i rekomanduar për kontrate ka vendosur një numër i cili nuk korrespondon dhe se e njëjta kontratë nuk është e ndare ne Lote.

Në Pjesa II. Përshkrimi i çmimeve, AK ka kërkuar qe te vendosen çmimet njësi për secilin nga 6 pozicionet. OE nuk i ka respektuar dispozitat ligjore dhe njëherit vete kërkesën e AK, duke mos e plotësuar listën e çmimeve për secilin pozicion ashtu siç është kërkuar ne dosje te tenderit si dhe ashtu siç e parashohin dispozitat ligjore te Lpp-së.

Dëshmia 1

Ne nenit 18 te Rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurim publik, shumë qartë shkruan se **OE duhet të plotësojë dhe të nënshkruaj formularin (dy pjesët), sepse në qoftë se formulari nuk është plotësuar kjo do te thotë se nuk ka oferte.**

Me këtë rast OE i rekomanduar për kontrate nuk e ka plotësuar formularin e tenderit, përkatësisht listën e çmimeve duke mos i vendosur çmimet per njësi ne te gjitha pozicionet e kërkuara nga AK KEK.

Dëshmia 2

Për me tepër, papërgjegjshmërinë e OE te rekomanduar për kontrate e vërteton edhe neni 39 Sqarimi i tenderëve i rregullave dhe UOPP-se, ku ne mënyrë shprehimore i përshkruan situatat si te veprohet nga zyrtaret e AK,

Situata 1.

Mungon çmimi	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ

Situata 2.

Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ

Situata 3.

Lista e çmimeve nuk është plotësuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ

Dëshmia 3

Pra, me këtë rast komisioni i vlerësimit është dashur t'i respektoje dispozitat ligjore dhe ta refuzoje tenderin pasi qe OE i rekomanduar për kontrate nuk i ka vendosur çmimet për njësi ne formularin e listës se çmimeve, dhe se është i papërgjegjshëm.

Duke u bazuar ne shkeljet e lartpërmendura kërkojmë nga OSHP qe te anuloje vendimin për dhënie te kontratës, dhe te vazhdoje me rekomandimin e OE te radhës te përgjegjshëm.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Tani per tani te papercaktuara

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*